



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 795
Datë: 22/3/2019

Rektori i Universitetit të Prishtinës në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 25 dhe 28 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, me qëllim të implementimit të pikës 6 të Vendimit nr.489101B, dt. 8.11.2018, të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë merr këtë

V E N D I M

- I. Tarifa për vijimin e mësimit me një modul në lëndët klinike, në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë, për studentët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit baçelor (themelor), në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, departamenti i Biologjisë, drejtimi Biologji aplikative dhe drejtimi Biokimiko-Fiziologjik, është në lartësi prej 1,000.00 (njëmijë euro).
- II. Studentët obligohen që të paguajnë 50% të tarifës së shpenzimeve si në pikën I, të këtij vendimi, respektivisht nga 500,00 € secili, ndërsa 50% të shumës së mbetur, respektivisht nga 500,00 € do të mbulohen nga MASHT-i, bazuar në pikën 6, të Vendimit nr. 489101B, dt. 8.11.2018, të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- III. Njoftimi për kohën e fillimit të mësimit dhe procedurat rreth regjistrimit të moduleve do të publikohen nga Fakulteti i Mjekësisë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet

1. Arkivit të UP-së;
2. Fakultetit të Mjekësisë;
3. MASHT-it;
4. Zyrës së TI-së në UP dhe
5. Për publikim në web-faqe të UP-së



Prof. dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së